



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

Programi i Bursave Postdoktorale Premium Momentum MSCA

"Momentum MSCA" në Hungari ka shpallur thirrjen për aplikimin për programin e bursave postdoktorale, i cili bashkëfinancohet nga Bashkimi Evropian dhe Sekretariati i Akademisë Hungareze të Shkencave nën grantin prestigjioz Marie Skłodowska-Curie Actions.

Kohëzgjatja e programit është janar 2025-dhjetor 2029. Kandidatët e të gjitha shtetësive mund të aplikojnë sipas kriterëve të mëposhtme:

- Aplikantët duhet të kenë një diplomë doktorale në momentin që mbyllet afati i aplikimeve për Programin Momentum MSCA. Kërkuesit që kanë mbaruar me sukses disertacionin e doktoratës, por ende nuk e kanë marrë formalisht diplomën, gjithashtu mund të aplikojnë. Dokumentacioni mbështetës do të kërkohet dhe verifikohet para lidhjes së kontratës.
- Kërkuesit që aplikojnë nuk duhet të kenë banuar apo zhvilluar aktivitetin e tyre kryesor (punë, studime, etj) në Hungari për më shumë se 12 muaj gjatë 3 viteve të fundit.
- Kërkuesit që janë tashmë të punësuar në një nga organizatat mikpritëse të "Lendület" Momentum nuk mund të aplikojnë.
- Vetëm kandidatët që kanë dorëzuar aplikime të plota (përfshirë të gjitha informacionet dhe dokumentacionin e kërkuar) në gjuhën angleze, përmes platformës online të dorëzimit deri në afatin e caktuar, do të merren parasysh për vlerësim teknik të mëtejshëm.

Thirrja e parë për aplikime hapet në 2 Prill 2025. Aplikimi do të kryhet përmes formularit online në faqen Momentum MSCA - <https://momentummsca.mta.hu>

DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS